



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Referencë:	
Për/Za/To:	<i>Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës</i>
CC:	
Përmes/Preko/Throgh:	
Tema/Subjekat/ Subjektet:	<i>Raport për gjashtë mujorin e parë të 2022-ës për punën e Ekzekutivit</i>

Raporti është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Me 21.06.2022, është publikuar njoftimi për organizimin e takimit të parë publik me qytetarë i kryetarit, Kadri Rahimaj për punën gjashtë (6) mujore për vitin 2022. Organizimi i takimit është bërë nga kryetari-kabineti i kryetarit dhe zyra për informim.

Ndërsa për shkak që në njoftim ishte përcaktuar data 12 qershor për mbajtjen e takimit, kjo datë ishte ditë pushimi me rastin e festës së Kurban Bajramit, andaj u bë plotësimi ndryshimi i vendimit dhe u publikuar më datën 30.06.2022.

Publikimi në uebfaqe të komunës

Data: 21.06.2022

Njoftimi:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/19093-AL-1.pdf>

Serbisht: <https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/19093-SR.pdf>

Data: 30.06.2022

Njoftimi:

Shqip: https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/20264_30062022145122.pdf

Serbisht: https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/20264_30062022145122.pdf

Publikimi në Platformën për Konsultime Publike:

Data:21.06.2022

<http://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20513&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Rikujtimet:

Më 30.06.2022 në Facebook:

<https://ëëë.facebook.com/photo/?fbid=398860612276277&set=a.288064086689264>

-Me 12..07.2022 duke filluar nga ora 20:00, është mbajtur takimi publik me qytetarë, në këtë konsultim të pranishëm kanë qenë rreth 100 qytetarë dhe janë dhënë katër pyetje.

Takimi është mbajtur në Amfiteatrin e Shtëpisë së Kulturës “Isa Kastrati”.

Të pranishëm në konsultim kanë qenë:

Kryetari i Komunës, Kadri Rahimaj, kryesuesi i KK-Kamenicë, Liridon Kasrati, shefi i kabinetit të kryetarit, Vaxhid Rehepaj, drejtoresha e Administratës së Përgjithshme, Merita Agaj, drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Afrim Dervishi, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Uran Berisha, drejtoresha e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Diana Kryeziu, drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Eurona Hoda, drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, Zotrim Kastrati, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rina Huruglica, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Kujtim Kallaba, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Shpend Morina, drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës, Burbuqe Leka, zyrtarë nga Zyra e Informimit dhe të tjerë.



Hapja e takimit është bërë nga zëdhënësja e Komunës, Lidiona Marovca, e cila ka prezantuar Kabinetin Qeverisës në krye me Kryetarin Rahimaj. Ajo ka thënë se ky takim publik mbahet për të paraqitur raportin e punës së kryetarit dhe kabinetit të tij për periudhën 6-të mujore të viti 2022.

“Pas përfundimit të fjalës së kryetarit do të ken rastin që drejtorët ta prezantojnë punën e tyre në pika të shkurtra, dhe edhe ju të pranishëm të merrni fjalën nëse keni ndonjë pyetje drejtur kryetarit ose drejtorive mund ta shtroni. Tani ia kaloj nfjalën kryetarit Kadri Rahimaj”, ka thënë zëdhënësja Lidiona Marovca.

Kryetari, Kadri Rahimaj në fillim të takimit ka falënderuar qytetarët, kuvendarët, shoqërinë civile, zyrën e informimit dhe gjithë të pranishmit tjerë në takim, duke thënë se ky raportim siç ishte planifikuar edhe u realizua për të paraqitur punën dhe përkushtimin 6-të mujor të qeverisjes.

Këtë diskutim e kemi ndarë në tri pjesë:

- 1.Si e gjetëm Komunën
- 2.Krijimi i Kabinetit/Drejtorët
- 2.Investimet e Siguruara



Si e gjetëm Komunën?

Komunën e gjetëm me 461,070.15€ Borxhe, 437,319.35€ Suficit, 14 Institucione Arsimore me U.D. për 4 vite, QKMF me U.D, nuk jemi përfitues të grantit të performancës për vitin 2020 dhe as 2021, Komunë jo-transparente, PZHK të pa aprovuar, Arkivë të fshirë, Marrëveshje me institucionet dhe organizata ndërkombëtare të zhdukura, Kompjuter të formatizuar dhe me fjalëkalime. Për të gjitha këto na është dashur kohë që ta marrim në duar gjendjen.

Zgjedhja e Kabinetit

Edhe pse në dhjetor e kemi marr mandatin, krijimin e kabinetit e kemi bërë me 10 shkurt. Na ka marr pak më shumë kohë deri sa i kemi përzgjedhur Drejtorët dhe njerëzit adekuat.

Një gjë është e mirë për Komunën tonë sepse edhe udhëheqësi paraprak ka qenë Kryetari më i ri në Kosovë, edhe unë tani jam kryetari më i ri në Kosovë. Kështu që edhe kabineti ynë përbëhet nga të rinjtë ku 32.5% është mosha mesatare, ndërsa 54.5% e kabinetit përbëhet nga gratë dhe vajzat.

Kemi premtuar Qeverisje të hapur dhe transparente. Është votuar Plani i Transparencës Komunale, të gjitha vendimet e Kryetarit dhe Kuvendit Komunal publikohen në ueb faqen zyrtare, janë publikuar të gjitha kontratat për shfrytëzimin e pronave publike që janë dhënë nga KK ndër vite, bëhet publikim i plotë i të gjitha kontratave në procesin e prokurimit. Një gjë që po e bëjmë për herë të parë në qeverisje është raportimi i rregullt mujor i drejtorëve dhe këto raporte publikohen në uebfaqen zyrtare, poashtu në vazhdimësi publikohen shpenzimet për dreka dhe darka zyrtare, ku janë shpenzuar 0 euro për dreka dhe darka zyrtare.

73,299.50 euro janë kursyet nga anulimi i vendimit për transport të nxënësve që nuk shfrytëzohej nga askush. Janë larguar mbi 300 orë fiktive në sistemin arsimor, ku nga këto kursehen rreth 14,000 euro në muaj, ose 168,000 euro në vit.

Kemi rritur të hyrat vetanake për 8.44%, ndërsa të hyrat vetanake indirekte për 36.17%. Kemi zvogëluar shpenzimet buxhetore për 4.91%. Kemi bërë 3-fishim të subvencioneve në bujqësi, si dhe për herë të parë nga 0€ në 50,000€ subvencione në arsim. Kemi zvogëluar shpenzimet e karburanteve për vetura zyrtare për 20,000 euro (71%). Poashtu ajo që kemi bërë si qeverisje është që nuk kemi lejuar dukurit negative të legalizohen. Kështu kemi pranuar të jemi present në rrënimin e Kazinove Ilegale.

Kemi premtuar stabilizimi të procesit arsimor. Kemi rikthyer në proces mësimor 441 fëmijëve, në fshatrat: Busavatë, Petrit, Karaqevë e Eperme, Shipashnicë e Poshtme dhe Kopernicë.

Siç e dini ne kemi marr mandatin në kohë të ftohta dimri andaj kemi vendosur Linja për Asistim dhe Vegza për Raportim. Kemi hapur linjën për asistim, për rrugët të cilat kanë qenë të mbuluara me borë, në mënyrë që të intervenohet sa më shpejt. Në ueb faqe është hapur vegza për raportim, ku qytetarët mund të raportojnë për problemet e sigurisë në bashkësi, si dhe mund të parashtrajnë pyetje dhe të marrin përgjigje online.

Një gjë të cilën e ka bërë drejtoresha e Shëndetësisë, Eureka Hoda, të cilën e falënderoj është kontrolla për fëmijët. Të gjithë nxënësit kanë kryer testet e COVID-19 nga ekipet mobile të QKMF-së.

Subvencionim i foshnjeve ka qenë edhe më herët por që për arsye të mungesës së mjeteve financiare është stopuar, andaj janë nënshkruar vendimet për subvencionimin e Foshnjeve të posalindura.

Po ashtu pas orarit të punës e kemi bërë rregull edhe takimin me qytetarë bashkë me deputetën Arta Bajraliu, ku qytetarët adresojnë çështje të ndryshme, dhe sa i përket nivelit lokal ato çështje drejtohen tek unë ndërsa në lidhje me nivelin qendror i drejtohen deputetës Artë. Janë realizuar mbi 500 takime me qytetarë.

Kemi dhuruar 740 pako ushqimore në bashkëpunim me MATKOS, JETIMAT E BALLKANIT, VIVA FRESH, GURIS, TIKA DHE ISLAMIC RELIEF.

Kamenica ka një diasporë të mrekullueshme e cila përkujdeset mjaftshumë për vendlindjen e saj. Kemi qenë duke qëndruar në një kaiferi kur ka ardhur një qytetarë i Kamenicës që jeton në diasporë e që ka dashur të mbes anonim dhe ka shprehur dëshirën për të dhuruar si donacion dy makineri për pastrimin e dyshemesë. Ato janë sistemuar njëra tek Palestra Sportive dhe tjetra tek Shkolla "Sejdi Kryeziu.



Investimet e siguruar

Kemi bërë inicimin e disa Amandamenteve në hartimin e buxhetit.

Amandamentet e inicuar janë: NDËRTIMI I KOLEKTORËVE PËR UJRAT E ZEZA Shipashnicë Ep. dhe Hogosht, NDËRTIMI I ÇERDHES NË FSHATIN KORETIN, ASFALTIMI I RRUGËS VARREZAT E DËSHMOREVE – JALLAQË - 8 KM.

Janë arritur investime në vlerë 300,110€ për zbatimin e masave të efijencës, 117,083.42€ për Qendrën për punë sociale, 183,026.98€ për Gjymnazin "Ismail Qemali". 204,881.35€ për Parkun e Teknologjisë, 152,400.75€ për Shkollën "Metush Krasniqi" në Roganë, 932,739.86€ për rrugë dhe trotuare,

Asfaltimi i rrugës "Ramadan Kallaba" në Roganë,

Asfaltimi i rrugës "Banimi i ri" në Roganë,

Asfaltimi i rrugës "Maliq Selishta" në Karaqevë,

Asfaltimi i rrugës "Bugaqaj" në Koretin,

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik dhe trotuarit

Kamenicë-Berivojcë,


Asfaltimi i rrugës "Arifi" në Leshtarë

400,000€ për projektin më të madh turistik në Kamenicë. Mbështetet nga MAPL dhe UN-Habitat

në kuadër të projektit CIF. Nuk e kuptoj arsye pse opozita nuk ulet dhe të diskutoj me ne këtë çështje se përse nuk e vtojnë këtë projekt.

350,000€ për sistemin e ujitjes së tokave bujqësore. Mbështetet nga Ministria e Bujqësisë, ndërtimi i digës në Lumin Desivojca për ujitjen e mbi 500ha tokë të fshatit Muqivërc.

50,000€ për rrugën në Berivojcë. Rruga Egzodi, mbështetet nga MAPL.



Kemi nënshkruar kartën për Komunën e Gjellbër

Nëpërmjet kësaj Karte, do të përmirësohet performanca ekonomike, do të krijohen ide të reja biznesi, si dhe do të përmirësohet aspekti mjedisor i komunës, me qëllim në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

120,000€ për asfaltimin e rrugëve

- Rr. Dardha, Karaqevë e Epërme
- Rr. Selim Genga, Karaqevë e Epërme
- Rr. Asllan Thaqi, Karaqevë e Epërme
- Rr. Lazim Rexhepi, Segmenti 1 dhe 2, Petrit
- Rr. Lut Vaku, Kamenicë
- Rr. Ahmet Qaushi, Hodonoc
- Rr. Zhujë Selmani, Berivojcë
- Parkingu i Xhamisë, Berivojcë
- Rr. Beteja e Uçk Mareci, Kamenicë
- Ndërtimi me zhavor në Tuxhec

Kemi filluar ndërtimin e Palestres Sportive në Fshatin Koretin. Po ashtu është nënshkruar

Marrëveshja me Fondacionin Jeshil për një zgjidhje të qëndrueshme për mbeturinat organike.
Pra për vetëm 6 muaj,
mbi 3 milion euro investime nga marrëveshjet.



E ardhmja e ndritur

26,000€ të dedikuara për rininë, ku në bashkëpunim me Fondacionin JAHJAGA kemi ndarë kod të veçant buxhetor për rininë, përmes të cilit ata mund ti realizojnë aktivitetet e tyre. Ndërsa po e krijojmë Qendrën e karrierës ku kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit për projektin për rritjen e nivelit të punësimit për të rinj 'EYE'.

Praktikë me pagesë për të rinjtë, ku në bashkëpunim me UNDP, 22 të rinjë do ta fillojnë praktikën me pagesë
10 prej tyre në IT, ndërsa 12 të tjerë në institucione publike dhe në sektorin privat.

Mundësi studimesh në SHBA ku në bashkëpunim me AAC-EdUSA Kosovo, të rinjëve tanë i mundësohen trajnimet, kurset e gjuhës, puntoritë dhe sesionet informuese të gjitha falas. Kemi angazhuar 6 mësues mbështetës për fëmijë me nevoja të veçanta. Kamenica është pajisur me rentgen dhe mamograf të teknologjisë së fundit.


Pas fjalimit të kryetrit edhe Drejtorët e Drejtorive komunale kanë paraqitur në pika të shkurtra punët e tyre, të cilat ishin pjesë e punës së Zyrës së Kryetarit.



Pas përfundimit të diskutimit është hapur edhe debate me qytetarë lidhur me pyetjet apo komentet që ata kishin për punën 6-mujore të Ekzekutivit.

Në këtë diskutim ishin disa kërkesa:

- Kërkesë për Infrastrukturën Rrugore në Malësi
- Kërkesë për shtimin e stafit në Qendrën për Punë Sociale (QPS)
- Makinë për nevojat e zyrtarëve të QPS-së
- Shtrimi i Trotuarit afër QPS-së



Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet/Pyetje	Njoftimi
Diskutim Publik për gjashtë mujorin e parë të 2022-ës për punën e Ekzekutivit	Zyra e Kryetarit	F M T Rreth 100	Amfiteatri i Shtëpisë së Kulturës ‘Isa Kastrati’- Kamenicë	4 Komene	Data: 21.06.2022 Njoftimi: Shqip: https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/19093-AL-1.pdf Serbisht: https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/19093-AL-1.pdf

					<p>22/06/19093-SR.pdf</p> <p>Data: 30.06.2022</p> <p>Njoftimi:</p> <p>Shqip: https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/2026430062022145122.pdf</p> <p>Serbisht: https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/06/2026430062022145122.pdf</p>
--	--	--	--	--	---

Zyrtare për Diskutime Publike:
Valdete Berisha-Murina

